

LIGJ
Nr. 64/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8391, DATË 28.10.1998,
“PËR SHËRBIMIN INFORMATIV KOMBËTAR”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8391, datë 28.10.1998, “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

1. Titulli i ligjit ndryshohet dhe zëvendësohet me “Për Shërbimin Informativ të Shtetit”.
2. Kudo në përmbajtje të ligjit bëhen këto ndryshime:
 - a) emërtimi “Shërbimi Informativ Kombëtar” zëvendësohet me emërtimin “Shërbimi Informativ i Shtetit”;
 - b) shkurtimi “SHIK” zëvendësohet me shkurtimin “SHISH”;
 - c) emërtimi “Nënkomisionit të Përhershëm Parlamentar” zëvendësohet me fjalët “komisionit përgjegjës për sigurinë”;
 - ç) fjalët “sigurimit kombëtar” zëvendësohen me fjalët “sigurisë kombëtare”;
 - d) fjalët “sigurimin kombëtar” zëvendësohen me fjalët “sigurinë kombëtare”.

Neni 2

Në paragrafin e parë të nenit 3 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Tri nënndarjet e para ndryshohen si më poshtë:

“Mbledh informacion brenda dhe jashtë vendit në funksion të sigurisë kombëtare, sigurisë kolektive dhe sfidave globale.

Mbledh informacion për kërcënimet që vijnë nga aktiviteti i shërbimeve të inteligjencës së huaj, në të gjitha format që shprehet dhe shfaqet, në funksion të ruajtjes së integritetit, pavarësisë dhe rendit kushtetues.

Mbledh informacion për terrorizmin dhe ekstremizmin, krimet kundër mjedisit, prodhimin dhe përhapjen e armëve të dëmtimit në masë, si dhe për stabilitetin e brendshëm dhe rajonal.”.

2. Pas nënndarjes së tretë shtohen dy nënndarje me këtë përmbajtje:

“Mbledh informacion për kërcënimet ndaj sigurisë ekonomike, kërcënimet kibernetike dhe kërcënimet hibride, me impakt në mjedisin e sigurisë së vendit.

Mbledh informacion për kërcënimet ndaj infrastrukturës kritike dhe të rëndësishme të Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 3

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Nënndarja e fundit e paragrafit të tretë shfuqizohet.
2. Në fund të nenit shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Drejtori dhe zëvendësdrejtori i SHISH-it përfitojnë pagë bazë, shtesë për vjetërsi dhe shtesë për natyrë të veçantë pune. Trajtimi financiar i tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Drejtori dhe zëvendësdrejtori trajtohen nga legjislacioni për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit.”.

Neni 4

Në paragrafin e fundit, të nenit 6 dhe në paragrafin parë, të nenit 7 fjala “Popullor” hiqet.

Neni 5

Në nenin 10 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në fund të paragrafit të parë pas fjalëve “të personelit” shtohen fjalët “si dhe nga detyrimet që rrjedhin nga ligji për të drejtën e informimit.”.

2. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Punonjësit e SHISH-it përjashtohen nga detyrimi për deklarimin e të ardhurave të përfuara nga paga, si dhe deklarimin e kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë. Kontrolli vjetor i tyre kryhet nga struktura e posaçme në Shërbimin Informativ të Shtetit, sipas procedurave të përcaktuara me akt të brendshëm të drejtorit të SHISH-it.”.

Neni 6

Në fund të nenit 13 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“SHISH-i ka të drejtë për akses në bazat e të dhënave shtetërore, i cili është i kufizuar sipas funksionit ligjor dhe rregullohet me marrëveshje ndërinstitutionale.”.

Neni 7

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 2.7.2026.